



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr 5242/prot
13

Datë 17/12/2018

VENDIM
Nr 32 datë 27/11/2018

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI, RRUGA
SKËNDERBEJ, DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK, PËR
QËLLIME SANITARE

Në zbatim të ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" të ndryshuar përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2; Vendimit Nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", me propozim të ABU Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

1.Miratimin e lejes për hapjen e një pus-shpimi për qëllime sanitare, për subjektin "Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik", ndërmarrje shtetërore, nga shpuesi profesionist "Hidrotek-Ko" sh.p.k. Pusi do të hapet në rrugën "Skënderbej" me këto të dhëna :

Koordinatat e grykës së pusit të projektuar në sistemin GAUSS KRUGER:

X=44 00 375; Y=45 77 938; Z=113 m

Koordinatat e grykës së pusit të projektuar në sistemin KRGJSH:

X= 483960.520; Y= 4577139.397; Z=113 m

- Kapaciteti i parashikuar 3.5 l/s
- Sasia që do jepet në përdorim 2 l/s
- Thellësia e shpimit të parashikuar 36 m
- Diametri i shpimit të pusit 350 mm
- Qëllimi i përdorimit sanitare

2. Mbyllet e çimentuar, të pjesës së sipërme të pusit sipas rekomandimeve të SHGJSH.

3.Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Dorina ÇAPUNI

KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

